



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS

Nr. 29

Datë. 22.03.2005

Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur më datën 22.03.2005 pas shqyrtimit të propozimit nr.73 të datës 07.03.2005 paraqitur nga Bordi i Drejtorëve, bazuar në nenin 4.1 të Rregullores 2000/45 nenit 29.2 të Statutit Komunal mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet - Rregullorja për mbrojtjen e monumenteve kulturore në Komunën e Fushë-Kosovës.
- II. Autorizohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport t'i inkorporojë vërejtjet e prezentuara nga anëtarët e Kuvendit në tekstin e ri.
- III. Obligohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport t'i zbatojë dispozitat e kësaj Rregulloreje në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- IV. Ky vendimi hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi Komunal.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryeshefit Ekzekutiv, UNMIK-ut, Drejtoratit për KRS dhe Arkivës.



Kryetari i Komunës

Skender Zogaj
Skender Zogaj



Kuvendi Komunal - Fushë-Kosovë
Škupština Opštine - Kosovo-Polje
Municipal Assembly of Fushe-Kosova

Rregullorja Komunale
Për Mbrojtjen Monumenteve Kulturore

Opštinski Pravilnik
O Odbrani Kulturnih Znamenitosti

Municipality Regulation
For Protection of Cultural Monuments

Shkurt 2005
Fushë-Kosovë

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport bazuar në kompetencat e tij dhe në bazë të nenit 4 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës Nr. 2000/45 të datës 11.08.2000, dhe nenit 78 të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës, propozon këtë:

Rregullore

Për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Rregullorja për mbrojtjen e monumenteve kulturore përfshin mbrojtjen, ruajtjen dhe evidentimin e monumenteve të kulturës që kanë rëndësi të posaçme kulturore dhe që tregojnë traditën, doket (zakonet) e popullatës të etniteteve të ndryshme (shqiptarë, serbë dhe ashkalinjë) që jetojnë dhe veprojnë në komunën e Fushë-Kosovës.

Neni 2

Monumente të kulturës konsiderohen ato që në vete bartin vlera të rëndësishme kulturore që tregojnë trashëgiminë kulturore, kombëtare dhe traditën e kultivuar nëpër breza nga banorët e këtij rrethi.

Të tilla konsiderohen: xhamitë, kishat, shkollat, shtëpitë muze, bustet dhe objektet tjera kulturore.

Neni 3

Çdo monument kulturor, që prezenton trashëgiminë kulturore të etniteteve të ndryshme, do të mbrohet me këtë Rregullore.

MBROJTJA E MONUMENTEVE

Neni 4

Monumentet kulturore mbrohen me qëllim:

- (a) të ruajtjes së monumenteve në gjendjen e tyre burimore,
- (b) pengimin e çdo veprimi të mundshëm të individëve që mund të ndryshojë pamjen e monumenteve kulturore të trashëguara dhe mbrojtura nëpër breza,
- (c) ruajtjen dhe shënjimin e lokacioneve të zbuluara dhe atyre që mund të zbulohen në të ardhmen e të cilat janë atraktive për gjurmime arkeologjike.

Neni 5

Mbrojtja e monumenteve kulturore në komunën e Fushë-Kosovës bëhet në koordinim të plotë mes Drejtoratit për Kulturë, Rini, Sport dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës.

Neni 6

Në ushtrimin e këtyre detyrave të mbrojtjes së monumenteve kulturore Drejtorati Komunal për Kulturë, Rini dhe Sport do të bashkëpunojë ngusht edhe me Arkivat, Muzeun etj.

Neni 7

Drejtorati Komunal për Kulturë, Rini dhe Sport për mbrojtjen me sukses të monumenteve kulturore kryen këto punë:

- (a) ndërmerr masat e parashikuara për mirëmbajtjen e monumenteve kulturore, bazuar në urdhëresat dhe dispozitat ligjore në fuqi të nxjerrura nga niveli qendror për fushën në fjalë.
- (b) kryen punë në lidhje me mbrojtjen dhe kultivimin e mëtejshëm të vlerave historike, artistike e shkencore.
- (c) përkujdeset dhe nxit studjuesit për gjurmime arkeologjike të monumenteve ekzistuese kulturore dhe zbulimin e lokacioneve tjera.

EVIDENTIMI I MONUMENTEVE

Neni 8

Drejtortit për Kulturë, Rini dhe Sport mban evidencë për lokacionet me rëndësi të posaçme kulturore dhe për lokacionet për të cilat supozohet me të drejtë se e kanë vlerën e tillë.

Neni 9

Çdo monoment kulturor për të cilin konsiderohet se ka cilësinë e tillë regjistrohet në regjistrin për monument të kulturës të cilën e mban Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport i Kuvendit Kumunal.

Neni 10

Regjistri i monumentit të kulturës përmban të dhëna lidhur me:

- (a) lloji i monumentit të kulturës,
- (b) kohën e zbulimit,
- (c) vendndodhja,
- (ç) ndryshimet eventuale të monumentit.

DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 11

Në monumentet e kulturës nuk mund të vëhen lajmërimet, shpalljet, reklamat e ndryshme, përveç në rastet kur për vënien e tyre merret leje e posaçme nga institucionet gjegjëse.

Neni 12

Për ndërmarrjen e çfarëdo veprimi që ngërthen në vete, ndërrimin e pamjes së monumentit të kulturës apo restaurimit të tij, duhet të ipet leje e veçantë nga institucionet që merren me këtë veprimtari.

Në qoftë se bëhet restaurimi i ndonjë monumenti të caktuar, punimet që bëhen lidhur me restaurimin e tij duhet të mbikëqyren nga ekspertët e kësaj fushe.

Neni 13

Programi i punës së mirëmbajtjes dhe ripërtrirjes së monumenteve të kulturës nxirret nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport për territorin e Kumunës.

Neni 14

Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport është i obliguar që në kontinuitet dhe bashkëpunim me Institutin Arkeologjik të Kosovës të hulumtojë për zbulimin, gjetjen dhe shënimin e lokacioneve atraktive të reja që mund të tregojnë lashtësinë e këtyre trevave nga periudhat parahistorike e këndej.

Neni 15

Çdo qytetarë, që kryen punët e tij ndërtimore, çoftë në tokën e tij apo diku tjetër, ka për detyrë që nëse hasë në vendzbulim arkeologjik, për të cilat supozohet me plot të drejtë se kanë vlerë të monumenteve kulturoro-historike, që ta ruaj lokacionin e caktuar nga asgjësimi apo dëmtimi eventual dhe për këtë ta lajmërojë Drejtoratin për Kulturë Rini dhe Sport dhe Institutin Arkeologjik të Kosovës.

Nëse Drejtorati Komunal për Kulturë Rini dhe Sport njoftohet nga qytetarët për ndonjë zbulim të tillë, atëherë kjo drejtori, ka për detyrë të kërkojë ndërprerjen e punimeve perkohësisht, nëse ekziston rreziku i drejtpërdrejtë i shkatërrimit apo dëmtimit të vendzbulimit, apo derisa ekipet profesionale të Institutit Arkeologjik të Kosovës të konstatojnë se lokacioni i caktuar e ka apo nuk e ka vlerën kulturore që është supozuar.

Neni 16

Organet kompetente, me rastin e hartimit të Planit Urbanistik të Komunës, kanë për detyrë ruajtjen e lokacioneve të cilat janë caktur si të një rëndësie të veçantë për monumentet kulturore dhe të bëjë shënjimin e tyre në përputhshmëri me Planin zhvillimor të tërësishëm të Komunës në të ardhmen.

Neni 17

Punët e mbikëqyrjes profesionale të monumenteve kulturore mund t'i ushtrojnë vetëm punëtorët që e kanë të kryer fakultetin përkatës profesional, sepse vetëm ata mund të konstatojnë sakt rëndësinë që ka monumenti.

Neni 18

Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport është i autorizuar që për mirëmbajtjen dhe restaurimin eventual të monumenteve kulturore në mungesë të mjeteve vetanake të kërkojë mjete financiare shtesë nga Institucionet qendrore të vendit.

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 19

Pasi të informohet Drejtorati Komunal për Kulturë, Rini dhe Sport, për çdo dëmtim të këtyre monumenteve, duhet të kërkojë nga ekspertët e kësaj fushe të bëjnë konstatimin e dëmit dhe të propozojnë masat që duhet të ndërmerren për restaurimin e monumentit.

Neni 20

Çdo individ që dëmton monumentet kulturore do të ndëshkohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 21

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 22

Për çdo çështje që nuk është e rregulluar me dispozitat e kësaj Rregulloreje aplikohen ligjet që nxirren nga Parlamenti i Kosovës për fushën e kulturës.

Neni 23

Procedura për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje është e njëjtë me atë të aprovimit.

Neni 24

Kjo Draft-Rregullore hynë në fuqi pas aprovimit nga Kuvendi Komunal.

Neni 25

U miratua në mbledhjen e Kuvendit Komunal të mbajtur me datën
22.03.2005



Kryetari i Komunes

Skënder Zogaj